

DEKLARATË

Ruajtja e paanësisë dhe integritetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rëndësi jetike për funksionimin e shtetit demokratik e ligjor

Shoqëritë me demokraci të qëndrueshme dhe të shëndetshme karakterizohen, ndër të tjera, nga një zbatim shumë i mirë i ligjit si dhe institucione të forta, të pavarura dhe llogaridhënëse. Në vendet me demokraci të brishtë dhe në tranzicion shtetformues si vendi ynë, ndërtimi dhe funksionimi në mënyrë të pavarur i institucioneve mbetet një sfidë e vështirë. Mirëfunksionimi i tyre mbi bazën e kushtetutës dhe ligjit është thelbësor për të frenuar ndikimin e vullneteve politike dhe për të siguruar besimin e qytetarëve në funksionimin e shtetit demokratik e ligjor.

Veçanërisht në kushtet e një krize politike, mirëfunksionimi i institucioneve dhe zbatimi pa ekuivok dhe i drejtë i ligjit është domosdoshmëri dhe garanci për ekzistencën e shtetit demokratik e ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) si një ndër institucionet e pavarura ka një rëndësi madhore në shëndoshjen e demokracisë pasi ai është **organi i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për ruajtjen e integritetit të votës dhe të vullnetit të qytetarëve**, i cili i shprehur nëpërmjet proceseve zgjedhore legjitimon pushtetin qeverisës dhe garanton fuqinë e votuesit.

KRIIK ka ndjekur në vazhdimësi funksionimin dhe vendimmarrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe sidomos veprimtarinë e tij në mbikqyrjen dhe përgatitjen e procesit zgjedhor të 30 qershorit 2019. **Deri më tani, në tërësi, vlerësohet një performancë pozitive e KQZ-së në informimin dhe nxitjen e aktorëve për të respektuar zbatimin e kërkesave dhe procedurave të parashikuara për ndërtimin e procesit të ardhshëm zgjedhor.**

KRIIK shpreh, gjithashtu, shqetësimin e tij për shkeljen në mënyrë flagrante të ligjit lidhur me vendimin e marrë nga KQZ-ja më datë 27.04.2019 për regjistrimin e subjektit zgjedhor “Partia Bindja Demokratike”¹.

Ky vendim jo vetëm që është në shkelje të afatit të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor², por gjatë marrjes së tij trupa e KQZ-së nuk mori parasysh as praktikën ligjore të ndjekur nga vetë ajo në Zgjedhjet Parlamentare 2013³ dhe në Zgjedhjet Vendore 2015⁴ dhe as vendimmarrjen e Kolegjit Zgjedhor të vitit 2013⁵, për mosregjistrimin e subjekteve zgjedhore të cilat, në afatin e përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, ishin subjekte zgjedhore për të cilat ishte marrë vendim nga Gjykata, por ky vendim nuk kishte marrë ende formë të prerë.

Për më tepër, në rastin e regjistrimit të subjektit “Partia Bindja Demokratike” vendimi i regjistrimit në Gjykatë⁶ është marrë dy ditë pas kalimit të afatit të regjistrimit të subjekteve zgjedhore, pra më datën 25 prill 2019.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Megjithëse Kryetari i KQZ-së z. Zguri solli në vëmendje të anëtarëve këtë shqetësim, katër anëtarët e tjerë të KQZ-së, jo vetëm nuk e morrën në konsideratë praktikën e vendosur, por në mënyrë të paprecedentë nuk zhvilluan asnjë diskutim⁷ apo parashtrim të qëndrimit të tyre dhe në bllok votuan pro regjistrimit të subjektit, përkundrajt votës kundër të Kryetarit të KQZ-së.

Ky qendrim është i kundërt edhe me qendrimin e vetë KQZ-së të shprehur në Deklaratën për Shtyp⁸ të datës 4 janar 2019, ku shprehet se për shkak edhe të kritikave nga misionet vëzhguese ndërkombëtare⁹, ajo është e vendosur këtë herë që të mos mirëkuptojë dhe as tolerojë vonesat në aplikimin për regjistrim të subjekteve zgjedhore.

Gjithashtu, shqetësues mbetet fakti që edhe administrata e KQZ-së, konkretisht Drejtoria Juridike dhe Sekretari i Përgjithshëm, në relacionin e përgatitur¹⁰ dhe atë të referuar¹¹ përpara trupës së KQZ-së në seancën e datës 27 prill e konsiderojnë konform ligjit dhe brenda afatit të 23 prillit kërkesën e paraqitur. Madje ata specifikojnë se bashkëlidhur me këtë kërkesë është paraqitur edhe vërtetimi i regjistrimit të subjektit në gjykatë, vërtetim i cili është lëshuar nga Kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë tre ditë më vonë, pra më datë 26 Prill 2019, një ditë përpara mbledhjes së KQZ-së.

Ende sot, në datën e publikimit të kësaj deklaratë, ky vendim nuk është zbardhur dhe nuk është bërë publik¹² në mënyrë që të gjykohej mbi arsyetimin e paraqitur rreth kësaj vendimmarrjeje. Nuk janë bërë publike as vendimet e tjera të marra në mbledhjen e asaj date, madje as ato të mbledhjes së mëparshme të datës 25 prill¹³, në kundërshtim me detyrimin e përcaktuar në Kodin Zgjedhor për publikimin e vendimeve të KQZ-së brenda 24 orëve nga marrja e tyre¹⁴.

Nga monitorimi i vazhdueshëm që i është bërë KQZ-së veçanërisht pas reformës zgjedhore të vitit 2012 e deri më sot, është evidentuar edhe herë të tjera sjellja e saj jo në përputhje me ligjin dhe me standarde të dyfishta. Madje në trajtimin e çështjeve me valencë politike dhe për të cilat ka patur qëndrime të kundërta të partive kryesore politike, trupa e KQZ-së ka operuar në vendimmarrjen e vet e ndarë më dysh duke reflektuar anshmëritë përkatëse politike.

Ndërkohë, në situatën e sotme, trupa e KQZ-së është e paplotë pas mospropozimit prej Partisë Demokratike të kandidaturave për dy vendet e mbetura bosh që në tetor të vitit 2018. Tre prej anëtarëve janë kandidatura të propozuara nga Partia Socialiste. Ndërkaq kandidati i propozuar nga Partia Republikane¹⁵ dhe ai i zgjedhur kryetar nga kandidatura të pavarura¹⁶, pas marrëveshjes politike të 18 Majit 2017, arbitrarisht ndërruan vendet¹⁷, duke zhbërë përfundimisht aspiratën e reformës zgjedhore të kryer në vitin 2012 për ndërtimin e një trupe të pavarur të KQZ-së.

Kuadri ligjor parashikon ankimimin e parregullsive të procesit në KQZ, në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit në Tiranë dhe në Gjykatën Kushtetuese, pavarësisht se kjo e fundit e ka përjashtuar veten me vendim¹⁸ për të shqyrtuar çështje zgjedhore. Për shkak të procesit të reformës në drejtësi, aktualisht Gjykata Kushtetuese nuk është funksionale. Ndërkohë të tetë gjyqtarët e Apelit, anëtarë¹⁹ të Kolegjit Zgjedhor janë futur në proces rivlerësimi²⁰ prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Nga tetë anëtarët e Kolegjit Zgjedhor njëri është konfirmuar në detyrë²¹ dhe një tjetër është shkarkuar²², ndërkohë që të dy vendimet janë apeluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit. Gjashtë anëtarët e tjerë janë tashmë në proces rivlerësimi²³.

Në këto rrethana dhe në kushtet kur opozita e dalë nga zgjedhjet e viti 2017 ka dorëzuar mandatet parlamentare dhe proteston në rrugë duke akuzuar mazhorancën se ka uzurpuar të gjitha pushtetet, sjellja dhe mirëfunksionimi i KQZ-së merr një rëndësi jetike. Rëndësi që lidhet jo thjesht me administrimin e një procesi zgjedhor, por me ruajtjen e besimit të publikut në rolin e institucionit të KQZ-së në mbikqyrjen, mirëorganizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor, si dhe në gatishmërinë e saj për të marrë në konsideratë

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

dhe shqyrtuar me objektivitet, vërtetësi e paanësi të gjitha pretendimet apo shkeljet ligjore që mund denoncohen apo që mund të vërehen drejtpërdrejtë nga vetë KQZ-ja.

Organi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i mandatuar në frymë e gërmë nga vullneti popullor i shprehur nëpërmjet referendumit për miratimin e Kushtetutës në 22 nëntor 1998, e më pas i materializuar në ligj pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008, si një organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet, duhet të marrë rol proaktiv në sigurimin e integritetit të të gjitha aspekteve të procesit zgjedhor.

Në këtë frymë, **Anëtarët e trupës së KQZ-së duhet të respektojnë vetëm ligjin dhe t'i përmbahen plotësisht betimit²⁴ të bërë para përfaqësuesve të popullit shqiptar në momentin e marrjes së detyrës.**

Anëtarët e trupës së KQZ-së dhe administrata e saj duhet të përpiqen të shmangin çdo influencë apo presion politik dhe çdo referim në sjelljen apo praktikën e mëparshme, të vendimmarrjeve ekstraligjore, jo korrekte apo me standarde të dyfishta, pasi çdo qasje tjetër do të minonte besimin e qytetarëve dhe do të rëndonte akoma më shumë situatën e tensionuar në vend nga kriza aktuale politike.

Tiranë, më 6 Maj 2019!

¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, [Njoftimi i Mbledhjes](#) datë 27.04.2019.

² Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 64 “Regjistrimi i partive politike në zgjedhje” pika 1.

³ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Vendimi nr. 241 datë 19.04.2013, “Për regjistrimin si subjekt zgjedhor të “Partia Civile e Shqipërisë” për zgjedhjet për Kuvendin të datës 23.06.2013” dhe Vendimi Nr. 279 datë 03.05.2013 “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Civile për rishikimin e vendimit të KQZ-së nr 241, datë 19.04.2013 “Për mosregjistrimin si subjekt zgjedhor i “Partia Civile e Shqipërisë”, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 23.06.2013”.

⁴ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Vendimi nr. 158 datë 16.04.2015 “Për shqyrtimin e kërkesës së “Partisë Shkodra 2015” për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015”.

⁵ Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë, Vendimi nr. 3, datë 27.04.2013.

⁶ Regjistruar me vendimin nr. 513 datë 25.04.2019 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Shih [materialet paraprake të mbledhjes së KQZ-së](#).

⁷ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, [regjistrimi video i mbledhjes](#) së KQZ-së (minuta 59.53 - 1.13.40).

⁸ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, [Deklaratë për Shtyp](#), datë 04.01.2019: “Afati ligjor për regjistrimin e partive politike për këto zgjedhje mbaron më datë 21 prill, kurse për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore në KQZ mbaron më datë 1 maj. Regjistrimi bëhet si gjithmonë pranë KQZ-së. Nëse partitë politike nuk respektojnë afatin e parë, ato nuk do të kenë mundësi të marrin pjesë në zgjedhjet e datës 30 qershor 2019. Nëse nuk respektojnë afatin e dytë, ato nuk mund të konkurrojnë si koalicione zgjedhore. Në të shkuarën KQZ -ja është kritikuar nga misionet vëzhguese ndërkombëtare për regjistrimin e subjekteve zgjedhore përtej afateve ligjore, ndaj është veçanërisht e vendosur këtë herë që të mos mirëkuptojë dhe as tolerojë vonesat në aplikimin për regjistrim. KQZ-ja u bën thirrje që sot partive politike që të organizohen në kohë për plotësimin dhe depozitimin e dokumentacionit të regjistrimit”.

⁹ Raporti Përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve për Kuvendin të 25 qershorit 2017, “I. Përmbledhje”, faqe nr. 2: “Ndonëse përfshirës në një shkallë të gjerë, procesi i regjistrimit të kandidatëve u ndesh me zbatimin përzgjedhës dhe jo të njëjtë të ligjit dhe, në disa raste, u mbështet në marrëveshjen politike dhe jo në ligj”.

¹⁰ [Materialet paraprake të mbledhjes](#) së KQZ-së.

¹¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, [regjistrimi video i mbledhjes](#) së KQZ-së (minuta 59:53 – 1:02:19).

¹² Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, [publikimi i vendimeve online](#) të KQZ-së.

¹³ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, [Njoftim i Mbledhjes](#), datë 25.04.2019.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

¹⁴ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 24 “Vendimmarrja në KQZ”, pika 3 “Çdo vendim i KQZ-së zbardhet brenda 24 orëve nga marrja e tij. Jo më pak se dy ekzemplarë origjinalë të vendimit ose, sipas rastiit, edhe të udhëzimit të KQZ-së, mbahen në arkivin e KQZ-së. Vendimet publikohen menjëherë në faqen zyrtare të KQZ-së”.

¹⁵ Vendim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Nr. 104/2015, datë 05.12.2015, “Për zgjedhjen e z. Klement Zguri anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, Fletore Zyrtare Nr. 220, datë 22.12.2015.

¹⁶ Vendim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Nr. 74/2016, datë 03.11.2016, “Për zgjedhjen e z. Denar Biba Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, Fletore Zyrtare Nr. 211, datë 08.11.2016.

¹⁷ Vendim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Nr. 78/2017, datë 22.05.2017, “Për zgjedhjen e z. Klement Zguri Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, Fletore Zyrtare Nr. 118, datë 23.05.2017.

Vendim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Nr. 79/2017, datë 22.05.2017, “Për zgjedhjen e z. Denar Biba anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, Fletore Zyrtare Nr. 118, datë 23.05.2017.

¹⁸ [Vendimi Nr. 53](#), datë 07.05.2013 i Gjykatës Kushtetuese.

¹⁹ [Anëtarët e zgjedhur të Kolegjit Zgjedhor](#) të Gjykatës së Apelit, Tiranë: Z. Artur Malaj, Z. Tomorr Shkreli, Z. Ridvan Hado, Znj. Lindita Sinanaj. Z. Shkëlqim Mustafa, Z. Gjin Gjoni, Z. Astrit Kalaja dhe Z. Sotiraq Lubonja.

²⁰ Në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” datë 30.08.2016.

²¹ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi nr. 62, datë 03.08.2018. [Rikonfirmim në detyrë](#) i z. Artur Malaj. Apeluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, [çështja \(JR\) nr.34/2018](#), datë 13.11.2018.

²² Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi nr. 68, datë 08.10.2018. [Shkarkimi nga detyra](#) i z. Sotiraq Lubonja. Apeluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, [çështja \(JR\) nr.39/2018](#), datë 07.12.2018.

²³ Z. Astrit Kalaja, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër ([Njoftimi i KPK-së datë 18.09.2018](#)); Z. Ridvan Hado, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, Z. Gjin Gjoni, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Znj. Lindita Sinanaj, Gjykata Administrative e Apelit ([Njoftimi i KPK-së datë 16.11.2018](#)); Z. Shkëlqim Mustafa, Gjykata e Apelit Tiranë ([Njoftimi i KPK-së datë 16.01.2019](#)); Z. Tomor Skreli, Gjykata e Apelit Gjirokastër ([Njoftimi i KPK-së datë 18.03.2019](#)).

²⁴ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 13 “Mandati dhe koha e punës e anëtarëve të KQZ-së”, pika 4 “Përpara fillimit të detyrës, anëtari i zgjedhur i KQZ-së kryen betimin para Kuvendit, në një ceremoni publike. Teksti i betimit është: “Betohe në nderin tim se do të angazhohem me të gjitha forcat e mia për realizimin e zgjedhjeve të drejta, të lira dhe demokratike në Republikën e Shqipërisë, do të siguroj dhe do të mbroj integritetin dhe fshehtësinë e votës, do të ruaj paanësinë në kryerjen e detyrës si anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe do të tregoj profesionalizëm në kryerjen e saj””.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania